

Koronavirusi

**KËSHU  
MBROHEMI NE.**

Përditësuar më 07.09.2021

# Tani rekomandohet edhe për të rinjtë mbi 12 vjeç: vaksinimi kundër Covid-19

## Informohuni tani





Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Bundesamt für Gesundheit BAG  
Office fédéral de la santé publique OFSP  
Ufficio federale della sanità pubblica UFSP  
Uffizi federal da sanadad publica UFSP

Më shumë për këtë:  
[bag-coronavirus.ch/impfung](https://bag-coronavirus.ch/impfung)  
Linja informuese 0800 88 66 44





## Tani mund të vendosni edhe ju


Koronavirusi ka cenuar ndjeshëm jetën tonë. Vaksinimi kundër Covid-19 është një hap tjetër i rëndësishëm për t'u kthyer në jetën normale. Pasi në fillim mund të vaksinoheshin vetëm të rriturit kundër koronavirusit, vaksinimi është miratuar edhe për të rinjtë nga 12 deri në 15 vjeç. Në paragrafët e mëposhtëm gjeni shumë informacione. Krijoni mendimin tuaj dhe zbuloni nëse dëshironi të vaksinoheni.

## A është vaksinimi i sigurt dhe i efektshëm?

Po, Instituti Zviceran i Barnave Swissmedic i ka kontrolluar plotësisht vaksinat kundër Covid-19. Studimet janë bërë në grupe të ndryshme moshash – edhe tek të rinjtë. Vaksinat janë të sigurt dhe kanë efekt dhe prandaj janë të lejuara në Zvicër. Në mbarë botën janë vaksinuar shumë të rritur dhe ndërkohë edhe shumë të rinj. Sëmundja e Covid-19 shkakton më shumë probleme shëndetësore sesa vaksinimi. Specialistët vazhdojnë t'i monitorojnë me kujdes vaksinat.

## Për kë dhe përse është i dobishëm vaksinimi?

– Vaksinimi ju mbron nga sëmundja e Covid-19. Vaksinimi parandalon para së gjithash që njeriu të sëmuret rëndë pas kontaktit me koronavirusin. Ai ju mbron edhe nga problemet e tjera shëndetësore pas një infektimi me koronavirus. Të dyja shfaqen shumë rrallë në grupin e moshës suaj.



- Në shkollë dhe kohën e lirë ju takoni shumë njerëz. Prandaj edhe ju keni kontakt me dikë që e mban virusin. Nëse jeni i vaksinuar, nuk duhet të shkoni në karantinë. Falë vaksinimit ju nuk mund të infektoheni dhe prandaj nuk duhet të shkoni as në izolim.
- Kush është vaksinuar e transmeton virusin më pak tek të tjerët.

Të gjithë personat mbi 12 vjeç u rekomandohet vaksinimi.

Vaksinimi është veçanërisht i dobishëm, nëse keni një sëmundje kronike. Ose nëse jetoni me një person që ka një sistem të dobët imunitar, për shembull për shkak të një sëmundjeje ose të një terapie.

[bag-coronavirus.ch/impfung](https://bag-coronavirus.ch/impfung)  
Linja kombëtare e informacionit  
për vaksinimin kundër Covid-19  
0800 88 66 44



## Krijoni idenë tuaj individuale

Në internet dhe në mediat sociale ka shumë të dhëna të pasakta ose edhe të gabuara rreth vaksinimit kundër Covid-19. Në [bag-coronavirus.ch/impfung](http://bag-coronavirus.ch/impfung) gjeni të gjitha informacionet e rëndësishme të Autoritetit Federal të Shëndetit rreth vaksinimit kundër Covid-19. Nëse keni pyetje, flisni me prindërit tuaj, persona të tjerë të besimit tuaj, me specialistë të mjekësisë ose telefononi linjën e informacionit.



## Vendimi juaj personal është i rëndësishëm

Vaksinimi është vullnetar. Informohuni mirë dhe flisni me të tjerët, për shembull me prindërit tuaj dhe më pas vendosni së bashku me ta ose vetëm, nëse dëshironi të vaksinoheni.



## Çfarë është në të vërtetë një vaksinim?

Vaksinimet ju mbrojnë nga shumë sëmundje, të cilat mund të kenë pasoja të rënda shëndetësore. Ato imitojnë infektimet dhe kështu ndihmojnë trupin tuaj për të zhvilluar forca mbrojtëse kundër viruseve dhe baktereve, pa u sëmurur. Ka mundësi që ju të keni bërë vaksinime që fëmijë ose madje edhe para pak kohësh ndaj sëmundjeve të ndryshme.

## Ku mund të vaksinohem?

Në faqen e internetit ose te linja e informacionit të kantonit tuaj, te mjekja ose mjeku juaj, te farmacistja ose farmacisti juaj ju mësoni, se ku mund të vaksinoheni në mjedisin tuaj.

## Si funksionon vaksinimi?

Ju bëni një injeksion në pjesën e sipërme të krahut dhe më pas vini një leukoplast. Pas rreth katër javësh ju bëni një vaksinim të dytë për t'u mbrojtur sa më mirë që të jetë e mundur.

[bag-coronavirus.ch/impfung](http://bag-coronavirus.ch/impfung)  
Linja kombëtare e informacionit  
për vaksinimin kundër Covid-19  
0800 88 66 44



## Si do të ndjehem unë pas vaksinimit?

Pas vaksinimit trupi krijon një mbrojtje kundër koronavirusit dhe sistemi juaj imunitar punon më shumë. Çdo njeri reagon ndryshe në një vaksinim. Është e mundur që pas vaksinimit të mos ndjeni më asgjë. Sidoqoftë, është shumë e mundur që të ndjeni reagimet e trupit tuaj ndaj vaksinimit.

Reagimet e shpeshta janë:

- Dhimbje/skuqje në vendin e injeksionit
- Dhimbjet e kokës
- Lodhje
- Dhimbje muskujsh dhe gjymtyrësh
- Temperaturë, ethe, të dridhura

Këto reagime janë në fakt të pakëndshme për të rinjtë, njerëzit e shëndetshëm, por nuk janë të rrezikshme.

Ato nuk janë arsye për t'u shqetësuar dhe duhet të kalojnë shpejt përsëri. Gjatë dy ditëve pas vaksinimit mos merrni përsipër shumë gjëra dhe dëgjoni trupin tuaj: Merrni me qetësi kur keni nevojë për pushim.

A ndjeni ndonjë gjë pas disa ditësh nga vaksinimi? Atëherë flisni me mjeken ose mjekun tuaj.



## Cilat efekte anësore janë të njohura?

Reaksionet e forta alergjike direkt pas vaksinimit ndodhin rrallë. Prandaj pas vaksinimit ju prisni për siguri edhe 15 minuta në vend, përpara se të shkoni në shtëpi. Gjatë 14 ditëve pas vaksinimit muskuli i zemrës ose perikardi mund të pezmatohet. Kjo gjë është shumë e rrallë dhe zakonisht mund të trajtohet mirë. Pezmatime të tilla pas një infektimi me koronavirus ndodhin shumë më shpesh sesa pas vaksinimit. Kontaktoni menjëherë mjeken ose mjekun tuaj, nëse gjatë ditëve pas vaksinimit keni dhimbje gjoksi, vështirësi në frymëmarrje ose aritmi të fortë.



## Për sa kohë më mbron vaksinimi?

Ekspertët aktualisht po hetojnë se për sa kohë do t'ju mbrojtë vaksinimi. Sipas gjendjes aktuale të hulumtimit, mbrojtja ndaj një sëmundjeje të rëndë zgjat të paktën dymbëdhjetë muaj – më shumë sesa nëse do të kishit Covid-19. Aktualisht nuk ka asnjë provë që mbrojtja ndaj sëmundjeve të rënda zvogëlohet ndjeshëm më pas. Sidoqoftë, mund të jetë e nevojshme të bëhet një vaksinim tjetër më vonë.

[bag-coronavirus.ch/impfung](https://bag-coronavirus.ch/impfung)  
Linja kombëtare e informacionit  
për vaksinimin kundër Covid-19  
0800 88 66 44

